



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

28.12.2022

UDHËZIM

Nr. 35. Datë 28.12.2022

24066

**“PËR  
PROCEDURAT STANDARDE TË RAPORTIMIT DHE MONITORIMIT TË RISQEVE  
FISKALE NGA NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME DHE NJËSI TË TJERA TË  
SEKTORIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 4/2 dhe nenit 65 të Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë:

**U D H Ë Z O N:**

**I. TË PËRGJITHSHME**

- a. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave standarde, procedurave dhe afateve që duhet të ndiqen nga të gjitha njësitë raportuese në procesin e monitorimit dhe raportimit të risqeve fiskale.
- b. Njësitë raportuese, në kuptim të Pikës a) mësipër, janë njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe ndërmarrjet publike me kapital shtetëror, përgjegjëse për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale, sipas fushës së përgjegjesisë përkatëse.
- c. Ky është një udhëzim i përhershëm (standard), në të cilin përcaktohen: mënyra e mbledhjes së të dhënave, analizimi dhe afatet e raportimit të risqeve fiskale, si edhe roli, përgjegjësitë dhe detyrat e Njërive Raportuese të përfshira në këtë proces. Udhëzimi formon bazën për përgatitjen e Deklaratës së Risqeve Fiskale.
- d. Deklarata e Risqeve Fiskale (DRF) është një dokument i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që përfshin mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe afatet për raportimin e risqeve fiskale. Objektivi i saj është të sigurojë që të gjitha risqet kryesore fiskale janë identifikuar, vlerësuar, mitiguar (kur është e mundur) dhe raportuar në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse, si një instrument në shërbim të vendimmarrjes së Qeverisë. DRF për vitin buxhetor paraardhës, paraqitet për informacion në Këshillin e Ministrave, çdo vit brenda muajit Maj të vitit buxhetor korrent dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në formën dhe masën e përcaktuar në varësi të vendimmarrjes dhe rrethanave përkatëse.
- e. Risk fiskal, në kuptim të këtij Udhëzimi, është: “Masa/Probabiliteti e/i devijimit të parashikimeve fiskale dhe buxhetore, në kontekstin e vitit buxhetor, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara që kanë lidhje me:
  - 1) zhvillimet makroekonomike
  - 2) të ardhurat e përgjithshme
  - 3) shpenzimet e përgjithshme dhe detyrimet e prapambetura
  - 4) borxhin publik dhe mjetet monetare disponibël
  - 5) financat vendore

- 6) *koncesionet/PPP*
- 7) *ndërmarrjet publike me kapital shtetëror*
- 8) *detyrimet kontigjente (psh, vendimet gjyqësore të Arbitrazhit, vendimet e GJEDNJ në Strasburg, etj)*
- 9) *ngjarje të tjera të paparashikuara, si fatkeqësi natyrore,*  
- *etj.*

## **II. Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e Deklaratës së Risqeve Fiskale (DRF)**

- a. Mbledhja, verifikimi dhe afatet e dorëzimit të informacionit:
  1. Të dhënat mbi risqet fiskale disponohen nga njësitë raportuese, sipas fushës së përgjegjësisë përkatëse.
  2. Mekanizmat specifike për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave variojnë në varësi të tipologjisë së risqeve dhe metodologjisë së përcaktuar për secilin risk. Ky informacion duhet të bazohet dhe të jetë në përputhje me të dhënat zyrtare, të gjeneruara konform standardeve të kontabilitetit, dhe të raportuara në përputhje me formatet pjesë përbërëse të këtij Udhëzimi, sipas Anekseve bashkëlidhur tij.
  3. Ky Udhëzim krijon mekanizmin për raportimin gjithëpërfshirës mbi bazë periodike të risqeve, referuar afateve të paracaktuara dhe një qasjeje sistematike për menaxhimin e të dhënave.
  4. Të gjitha njësitë raportuese, në kuptim të Pikës I/b mësipër, brenda datës 15 Prill të çdo viti buxhetor raportojnë pranë Njesisë përgjegjëse për monitorimin e risqeve fiskale (këtej e tutje emërtuar FRU) në MFE, sipas formateve standarde të raportimit në Anekset bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

## **III. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË PROCESIN E HARTIMIT TË DEKLARATËS SË RISQEVE FISKALE (DRF)**

### **Përgjegjësitë e FRU gjatë hartimit të deklaratës së risqeve fiskale**

1. FRU është njësia përgjegjëse për koordinimin e mbledhjes së informacionit mbi risqet fiskale dhe finalizimin e dokumentit të DRF-së, sipas afateve të përcaktuara në këtë Udhëzim.

### **Përgjegjësitë e njësive raportuese**

1. Njësitë raportuese në kuptim të këtij Udhëzimi, raportojnë pranë FRU sipas fushave të përgjegjësisë përkatëse dhe bazuar në formatet standarde dhe afatet e përcaktuara në këtë Udhëzim.
2. Ato janë përgjegjëse për cilësinë dhe përputhshmërinë e informacionit të raportuar prej tyre sipas fushave të përgjegjësisë përkatëse, informacioni i cili përfshihet në DRF.

## **IV. STRUKTURA E DEKLARATËS SË RISQEVE FISKALE (DRF)**

Formati për raportimin e informacionit të nevojshëm për hartimin e DRF, bëhet (por nuk kufizohet në) sipas Anekseve bashkëlidhur këtij Udhëzimi, përkatësisht:

### **1. Aneksi nr.1 për risqet lidhur me:**

- *zhvillimet makroekonomike*
- *të ardhurat e përgjithshme*
- *shpenzimet e përgjithshme dhe detyrimet e prapambetura*
- *borxhin publik dhe mjetet monetare disponibël*
- *financat vendore*

**2. Aneksi nr.2 për risqet lidhur me:**

- *koncesionet/PPP*

**3. Aneksi nr.3 për risqet lidhur me:**

- *ndërmarrjet publike me kapital shtetëror*

**4. Aneksi nr.4 për risqet lidhur me:**

- *detyrimet kontigjente (psh, vendimet gjyqësore të Arbitrazhit, vendimet e GJEDNJ në Strasburg, etj)*

**5. Aneksi nr.5 për risqet lidhur me:**

- *ngjarje të tjera të paparashikuara, si fatkeqësi natyrore (sipas rastit).*

Formati për paraqitjen e informacionit të nevojshëm për hartimin e risqeve fiskale dhe anekset e raporteve të risqeve fiskale, mund të ndryshojnë në varësi të nevojave specifike për përditësim dhe përmirësim të këtyre formateve. Gjithashtu, analiza dhe prezantimi i risqeve fiskale i nënshtrohen politikave dhe vendimmarrjes lidhur me to, në vitin buxhetor përkatës.

## V TË TJERA

Ky Udhëzim bëhet efektiv nga 1 Janar 2023 dhe për zbatimin e tij ngarkohen Njësitë Raportuese, si vijon:

- *Në MFE: drejtoritë përgjegjëse për çështjet makroekonomike, fiskale, buxhetore, të borxhit publik, thesarit, koncesioneve/PPP, financave vendore, harmonizimit të auditimit të brendshëm.*
- *Jashtë MFE: Ministrinë e Linjës dhe Institucionet Buxhetore, Ministria e Mbrojtjes/Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Avokatura e Shtetit, Ndërmarrjet publike me kapital shtetëror.*



## Aneksi nr.1 “Risqet fiskale të lidhura me Pikën IV/1”

a. Njësia raportuese: (psh Drejtoria përgjegjëse për politikat makroekonomike, MFE)

b. Burimi i të dhënave: \_\_\_\_\_

c. Informacioni i strukturuar:

Fusha në raportim: (psh Zhvillimet makroekonomike)
- Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës (t-1)
- Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor parardhës ( <i>devijime nga planifikimi, etj</i> ), duke cilësuar: <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Karakteristikat e risqeve</li><li>✓ Impaktin financiar/buxhetor të risqeve (kur është e mundur)</li></ul>
- Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara, duke cilësuar: <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Masat e marra (cilësore dhe/ose sasiore) për zbutjen e risqeve të evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës (nëse ka patur);</li><li>✓ Masat e pritshme, për të parandaluar materializimin e këtyre risqeve gjatë vitit aktual (t) buxhetor (nëse ka).</li></ul>
- Të dhëna analitike: <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Tabela e ecurisë së treguesve (<i>sipas përgjegjësisë</i>) për t-3 deri t+2;</li><li>✓ Paraqitja grafike e ecurisë së treguesve të mësipërm</li></ul>

## Aneksi nr.2 "Risqet fiskale të lidhura me Koncesionet/PPP"

- a. Njësia raportuese: Drejtoria përgjegjëse për Koncesionet/DPB, MFE
- b. Burimi i të dhënave: \_\_\_\_\_
- c. Informacioni i strukturuar:

<b>Fusha në raportim: Koncesionet/PPP</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Një vështrim i përgjithshëm narrativ i performancës së kontratave të koncesioneve/PPP, të raportuara nga Autoritetet Kontraktore, gjatë vitit buxhetor paraardhës (t-1), mbi portofolin aktual të Koncesioneve/PPP-ve.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Risqet e evidentuara sipas kontratave me mbështetje buxhetore, gjatë vitit buxhetor paraardhës (t-1), duke cilësuar:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Karakteristikat e risqeve të materializuara, referuar përcaktimeve kontraktuale</li><li>✓ Impaktin financiar/buxhetor të risqeve në fjalë.</li></ul></li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara për kontratat me mbështetje buxhetore, duke cilësuar:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Masat e marra (cilësore dhe/ose sasiore) nga autoritetet kontraktore, për zbutjen e risqeve të evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës (nëse ka patur);</li><li>✓ Masat e pritshme për t'u marrë nga autoritetet kontraktore, për të parandaluar ose minimizuar materializimin e këtyre risqeve gjatë vitit aktual (t) buxhetor (nëse ka).</li></ul></li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Të dhëna analitike:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Tabela e pagesave buxhetore për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, për vitet buxhetore (t-3) deri (t+2), plan/fakt.</li><li>✓ Paraqitja grafike e respektimit të rregullit fiskal të tavanit 5% ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës, për periudhën (t-3), (t-2), (t-1).</li><li>✓ Paraqitja grafike e peshës kumulative të vlerës së investimeve për koncesionet/PPP në vite, në % të PBB;</li></ul></li></ul>

### Aneksi nr.3 "Risqet fiskale të lidhura me Ndërmarrjet publike me kapital shtetëror"

- a. Njësia raportuese: (psh KESH sha, OSHEE sha, etj sipas relevances se periudhës në analizë)
- b. Burimi i të dhënave: \_\_\_\_\_
- c. Informacioni i strukturuar:

<b>Fusha në raportim: Performanca e disa prej ndërmarrjeve publike me kapital shtetëror</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Një vështrim i përgjithshëm narrativ i performancës financiare dhe jo financiare të vitit buxhetor paraardhës (t-1), të ndërmarrjes publike me kapital shtetëror, mbi bazë krahasimore me parashikimet e bëra.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor parardhës (<i>devijime nga planifikimi, etj</i>), duke cilësuar:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Karakteristikat e risqeve të materializuara</li><li>✓ Impaktin financiar/buxhetor të risqeve (kur është e mundur)</li></ul></li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara, duke cilësuar:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Masat e marra (cilësore dhe/ose sasiore) për zbutjen e risqeve të evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës (nëse ka patur);</li><li>✓ Masat e pritshme, për të parandaluar materializimin e këtyre risqeve gjatë vitit aktual (t) buxhetor (nëse ka).</li></ul></li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Të dhëna analitike:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Planet financiare vjetore për vitin paraardhës (t-1) / Të dhëna kryesore financiare për vitin paraardhës (t-1)</li><li>✓ Pritshmëritë e nivelit të treguesve kryesoë për vitin buxhetor aktual (t)</li></ul></li></ul>

**Aneksi nr.4 “Risqet fiskale të lidhura me detyrimet kontigjente (psh, vendimet gjyqësore të Arbitrazhit, vendimet e GJEDNJ në Strasburg, etj)”**

- a. Njësia raportuese: Avokatura e Shtetit/Ministritë e Linjës dhe Institucionet Buxhetore
- b. Burimi i të dhënave: \_\_\_\_\_
- c. Informacioni i strukturuar:

<b>Fusha në raportim: Detyrimet Kontigjente</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Lista e Vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar, ku të specifikohet:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ përshkrimi i vendimit (Nr. i çështjes/Data/ Emërtimi),</li><li>✓ forma e vendimit (vendim i formës së prerë/ në proces/ në pritje),</li><li>✓ pala përfituese,</li><li>✓ pala e paditur.</li></ul></li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Të dhëna financiare lidhur me Vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar ku të specifikohet:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Totali i detyrimit,</li><li>✓ detyrimi i faturuar,</li><li>✓ data e faturimit,</li><li>✓ pagesat dhe datat e pagesave,</li><li>✓ detyrimi i mbetur nga faturimi</li><li>✓ sqarime të tjera shtesë lidhur me specifika të vendimeve në proces dhe në pritje.</li></ul></li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Lista e Kostove administrative/ligjore/kontrata studiosh ligjore/anullime vendimesh etj për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar, ku të specifikohet:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Përshkrimi i vendimit (Nr. i çështjes/data/ emërtimi),</li><li>✓ kontrata e angazhimit për shërbimet e konsulencës (avokat/studio ligjore) për përfaqësim dhe mbrojtje,</li><li>✓ pala/ët përfituese,</li><li>✓ ofruesi i shërbimit (studio ligjore)</li></ul></li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Të dhëna financiare lidhur me Kostot administrative/ligjore/kontrata studiosh ligjore/anullime vendimesh etj për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar ku të specifikohet:<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Totali detyrimit bazuar në kontratë,</li><li>✓ afatet e detyrimeve bazuar në kontratë,</li><li>✓ detyrimi i faturuar,</li><li>✓ data e faturimit,</li><li>✓ pagesat dhe datat e pagesave,</li><li>✓ detyrimi i mbetur nga faturimi</li></ul></li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Përditësimi nga Avokatura e Shtetit i Regjistrimit gjithëpërfshirës të listës së vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe GJEDNJ, ku përfshihen ato të formës së prerë, ato në proces shqyrtimi dhe ato në pritje për shqyrtim (in queue), me vlerën financiare përkatëse.</li></ul>

**Aneksi nr.5 "Risqet fiskale të lidhura me fatkeqësi natyrore"**

- a. Njësia raportuese: **Ministria e Mbrojtjes/Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile**
- b. Burimi i të dhënave: \_\_\_\_\_
- c. Informacioni i strukturuar:

<b>Fusha në raportim: Fatkeqësi Natyrore</b>
- Një vështrim i përgjithshëm narrativ i profilit të territorit, nga probabiliteti i fatkeqësive natyrore ndaj të cilave figurojmë më të ekspozuar.
- Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës (t-1), duke cilësuar: <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Karakteristikat e risqeve të materializuara</li><li>✓ Impaktin financiar/buxhetor të risqeve në fjalë (kur është e mundur)</li></ul>
- Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara, duke cilësuar: <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Masat e marra (cilësore dhe/ose sasiore) për zbutjen e risqeve të evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës (t-1) (nëse ka patur);</li><li>✓ Masat e pritshme, për të parandaluar materializimin e këtyre risqeve gjatë vitit aktual (t) buxhetor (nëse ka).</li></ul>
- Të dhëna analitike: <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Tabela e fatkeqësive natyrore të regjistruara në vite, për periudhën (t-10) deri (t);</li><li>✓ Financimi nga buxheti i shtetit për fatkeqësitë natyrore të regjistruara në vite, për periudhën (t-10) deri (t);</li><li>✓ Paraqitja grafike e ecurisë së treguesve të mësipërm.</li></ul>